



Agricultural University of Tirana
Universiteti Bujqësor i Tiranës



**Autoriteti Shtetëror për
Informacionin Gjeohapësinor**

Nr. 236 prot. Tiranë, më 31.01 2019

Nr. 49 prot. Tiranë, më 01.02 2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

**AUTORITETIT SHETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR**

Në Tiranë, sot më datë 31.01 2019, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

“**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**” (UBT) është një Universitet Publik me adresë në Kodër-Kamëz, Tiranë me përfaqësues ligjor: Rektor **Prof. Dr. Bari MUSABELLIU**. Ky Universitet është themeluar në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor. Sot i njohur si UBT (Universiteti Bujqësor i Tiranës) është qendra e vetme e formimit universitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe këshillimit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit.

dhe

AUTORITETI SHETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG), është institucion publik qendror, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, Kati i Dytë, Tiranë, i

krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", misioni i të cilit është krijimi i infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, sipas standardeve evropiane të Direktivës 2007/EC "INSPIRE". ASIG përfaqësohet ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Lorenc Çala**.

Këtu e më poshtë referuar individualisht si "**Palë**" ose si "**Palët**".

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 15/2017 "*Për Arsimin dhe Formimin Profesional*", *Kodin e Punës dhe Kodin Civil* të Republikës së Shqipërisë si dhe në zbatim të Paktit për Universitetin.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve, për përdorimin sa më efektiv të informacionit dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, në mënyrë që të rritet cilësia e punës kërkimore shkencore dhe të përmirësohen shërbimet për publikun.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

- 2.1 Shkëmbim i informacionit gjeohapësinor si dhe i burimeve njerëzore me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore.
- 2.2 Programe për praktika profesionale dhe mësimore të studentëve.
- 2.3 Pranimi i studentëve praktikantë që plotësojnë kërkesat dhe mundësitë e krijuara nga ASIG.
- 2.4 Pjesëmarrje e ndërsjelltë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët.

2.5 Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta sidomos në fushën e trainimit.

2.6 Aktivitete të tjera.

Neni 3

Angazhimet dhe të drejtat e palëve

3.1 Angazhimet dhe të drejtat e ASIG

3.1.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, ASIG angazhohet që t'i ofrojë UBT informacionin që disponon për qëllime të punës mësimore dhe kërkimore sipas procedurave të miratuara.

3.1.2 ASIG merr përsipër të mirëpresë një numër të kufizuar studentësh që do të bëhen pjesë e programeve të praktikave mësimore të përcaktuara nga palët.

3.1.3 ASIG do të asistojë dhe trajnojë studentët e pranuar për praktikë mësimore në çdo proces të programeve të praktikës mësimore që do të zhvillohen në mjediset e tij.

3.1.4 ASIG angazhohet ti sigurojë UBT, kur është e nevojshme (ose kërkohet), vlerësime në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e praktikave të studentëve.

3.1.5 ASIG ka të drejtë të vendosë për numrin e studentëve që mund të kryejnë praktikën në mjediset e tij.

3.1.6 ASIG ka të drejtë të vendosë për kohën dhe për periudhën e përshtatshme të realizimit të programeve të praktikave profesionale në mjediset e tij.

3.1.7 ASIG ka të drejtë të ndërpresë praktikën për studentë të veçantë, ose praktikën si proces në tërësi, në rast se evidenton se studentët nuk respektojnë kushtet e rëna dakort paraprakisht mes palëve, ose kur sjelljet apo mosjelljet e studentëve mund të dëmtojnë ecurinë normale të punës.

3.2 Angazhimet dhe të drejtat e UBT

3.2.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Universiteti angazhohet të identifikojë nevoja për projekte konkrete bashkëpunimi mes palëve.

3.2.2 UBT angazhohet që do t'i vërë në dispozicion ASIG rezultatet e punës kërkimore shkencore të cilat vijjnë si rezultat i këtij bashkëpunimi

3.2.3 UBT angazhohet të kontribuojë në ofrimin e asistencës dhe ekspertizës për autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor për temat që lidhen me tokën (pedologjia, mbulesa e tokës, përdoriomi i tokës, infrastruktura bujqwsore dhe akuakultura, shpërndarja e specieve etj).

3.2.4 Universiteti ka të drejtë të përzgjedhë studentët potencialë që do të kryejnë programin e praktikës mësimore pranë ASIG.

3.2.5 Universiteti, me nënshkrimin e kësaj marrëveshje angazhohet që të bëjë të njohur programin e praktikave mësimore dhe ta pranojë ASIG si një nga partnerët e procesit mësimor.

3.2.6 Universiteti angazhohet që kur është e nevojshme të asistojë studentët, në mjediset e ASIG, para fillimit të programit të praktikës mësimore.

3.2.7 Universiteti ka të drejtë të marrë pjesë në proceset e monitorimit dhe të vlerësimit të studentëve kur kryejnë praktikat mësimore.

3.2.8 UBT angazhohet që të përmbushë kërkesat në lidhje me përdorimin e informacionit gjeohapësinor të marrë nga ASIG vetëm për qëllime jofitimprurese si dhe të marrë masa për mbrojtjen e të dhënave nga përdorimi i paautorizuar.

Neni 4

Dukshmëria në lidhje me kontributin e dhënë nga ASIG.

4.1 Universiteti merr përsipër dhe angazhohet të pasqyrojë foto dhe artikuj në faqen e tij zyrtare të internetit dhe/ose facebook në lidhje me kontributin e ofruar nga ASIG për aktivitete ose projekte të ndryshme.

4.2 Në rast aktivitete të përbashkëta kontributi dhe logo zyrtare e ASIG, duhet të përfshihen në të gjitha dokumentat e prodhuara për atë rast.

4.3 Në raste aktivitete ose projektet të tjera të mbështetura nga ASIG kontributi dhe logo zyrtare e ASIG duhet të jenë të vendosura në vende të dukshme publikisht.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të lidhet me një afat 5 (pesë) vjeçar, dhe hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit.

5.2 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar sa më sipër, nëse nuk ka kundërshtime nga të dyja palët mund të rishikohet procesi i një tjetër marrëveshjeje bashkëpunimi.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 7

Njoftimet mes palëve

7.1 Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar, me postë elektronike ose me faks. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës:

Person Kontakti: Prof. Asoc. Dr. Zydi Teqja, me detyrë Kryetar i Grupit Mësimor, Kërkimor në Arkitekturë Peizazhi

E-mail: zteqja@ubt.edu.al

Mobile: 00355 696169208

Për ASIG:

Person Kontakti: Orland Mato, Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit

E-mail: orland.mato@asig.gov.al

Mobile: 00355 672584212

7.2 Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet eventuale të përfaqësuesve.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

- 8.1 Ndryshimet ose shtesat e pjesëshme që do ti bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.
- 8.2 Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

**AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

Përfaqësuar nga:

Rektor

Prof. Dr. Bari Musabelliu



Përfaqësuar nga:

Drejtori i Përgjithshëm

Z. Lorenc Çala

